

VENDIM
Nr. 75, datë 29.1.2016

PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA TIRANË, TË DISA OBJEKTEVE DHE TË NJË SIPËRFAQEJE TRUALLI FUNKSIONAL, BRENDË TERRITORIT TË PRONËS NR. 1, ME EMËRTIM “GRUP DEPO, TË REPARTIT USHTARAK NR. 8837”, ME VENDNDODHJE NË SHKOZË, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Tiranë të disa objekteve dhe të një sipërfaqeje truall funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 11 699 (njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë) m², brenda territorit të pronës nr. 1, me emërtim “Grup Depo, të repartit ushtarak nr. 8837”, me vendndodhje në Shkozë, Tiranë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për ngritjen e një vendqëndrimi për strehimin e familjeve të komunitetit rom.

Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, hiqen objektet dhe sipërfaqja truall funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 11 699 (njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë) m², nga truall funksional i pronës nr. 1, me emërtim “Grup Depo, të repartit ushtarak nr. 8837”, me vendndodhje në Shkozë, Tiranë.

Bashkisë Tiranë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të objekteve dhe të truallit funksional të pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, kryetari i Bashkisë Tiranë, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryerëgjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Plan Vendosja e (Pronës nr.1)
Rep. Usht. nr.4451 Shkozë,Tiranë
(Objektet dhe siperfaqja që do të bëhet kalim kapital Bashkisë
Tiranë për strehimin e Komunitetit Rom)

Sistemi i koordinatave Shtetërore



